



Qendra Për Advokim Social
Rr.Vangjel Capo P2, Shk 2, Ap 26
Email:qendraqas@gmail.com

Data: 05.12.2023

Lenda: Kërkesë për informacion

Drejtuar: Agjensia Kombetare e Punesimit dhe Aftesive

Qendra për Advokim Social, ka si mision fuqizimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Shqipëri, duke reduktuar kështu edhe pabarazinë që ekziston mes komunitetit dhe pjesës tjetër të shoqërisë. QAS synon të kontribuojë dhe të mbështesë familjet dhe grupe të marginalizuara në përfitimin e shërbimeve sociale që ofrohen në nivel lokal e qendror, për të siguruar mbrojtjen dhe garantimin e të Drejtave të Njeriut, për fuqizimin e anëtarëve të komunitetit të përfshirë aktivisht në përmirësimin e kushteve të jetesës në shoqëri.

Ne fokus të punës së QAS ndër të tjera ka qenë dhe puna me vajzat dhe gratë pjesë e këtij komuniteti, duke marrë në konsideratë shumë probleme me të cilat ato përballen e në këtë mënyrë, qëllimi jonë i përgjithshëm ka qenë mbështetja e tyre dhe njëkohësisht zgjidhja e problemeve të mundshme me të cilat këto vajza dhe gra përballen.

Në këtë kuadër si dhe në vazhdimësi të projektit i cili po zbatohet aktualisht "Rritja e ndërgjegjes kolektive të grave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Tiranë mbi penalitetet e martesave fiktive", QAS është duke punuar ngushtë për të ndërtuar një vlerësim të përgjithshëm në lidhje me faktorët, shkaqet dhe pasojat që sjell kryerja e akteve të tilla siç janë martesat fiktive. Njëkohësisht për të realizuar vlerësimin ligjor dhe psikosocial, pra për të krijuar një analize me gjetje nga kuadri ligjor dhe psikosocial në lidhje me martesat fiktive kërkojmë të na vihet në dispozicionin:

- Sa gra kryefamiljare të divorcuara dhe me urdhermbrojtje janë ndermjetësuar përmes Programeve të Nxitjes së Punesimit referuar viteve 2021-2023?
- Sa gra dhe vajza janë trajtuar dhe trajtohen aktualisht nga skema e pageses së papunsisë, referuar viteve 2021-2023 (6-mujori i parë i vitit 2023)

Në pritje të përgjigjes nga ana juaj!

Romina Sefa

Drejtoresha Ekzekutive

